




Gerda dhe Hainci
nga Nikolaus Heidelbach

übersetzt von Gladiola Sadiku




Një ditë prej ditësh Gerda nuk mund t'i duronte më kukullat e saj.



Ajo krijoi vetë një burrë të vogël si lodër dhe e quajti Hainci.




Hainci ishte shumë i bukur, gjithashtu dhe mund të qeshte, sepse ajo ishte munduar shumë për ta krijuarkështu.




Natyrisht, ajo e merrte edhe në krevat
dhe i tregonte atij histori.




Të dielën e kaluar ajo doli shëtitje me të
dhe ai mund të ecte pothuajse vetë.




Të hënën e kaluar në mëngjes ai e
pickoi në këmbë.



Të martën e kaluar në drekë ai ia hëngri
të gjithë ushqimin.



Të mërkurën e kaluar në mbrëmje ai i bërtiti: Patë budallaqe!



Të enjten e kaluar ajo e përzuri.



Të premten e kaluar Hainci i ra edhe njëherë ziles.
Gerda nuk ia hapi derën.
Që prej asaj kohe ajo nuk ka dëgjuar më për të.



Fund